

Datë: 19.07.2024

## STATUTI dhe AKT THEMELIMI

### I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

"VERTIX" shpk.

#### KAPITULLI I

Forma, EMËRTIMI, OBJEKTI, SELIA, KOHËZGJATJA

##### Neni 1

###### Forma

Shoqëria "VERTIX" shpk (në vijim "Shoqëria") krijohet në formën e një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar, dhe veprimtaria e saj rregullohet me anë të këtij Statuti dhe Aktit të Themelimit.

Shoqëria vepron sipas legjislacionit shqiptar në fuqi.

Akti i Themelimit dhe Statuti janë në përputhje me legjislacionin shqiptar që ka karakter të detyrueshëm, ndërsa çështjet që nuk janë shprehimisht të parashikuara në to, plotësohen nga legjislacioni shqiptar.

##### Neni 2

###### Emërtimi

Emërtimi i Shoqërisë është "VERTIX" Sh.p.k.

Shoqëria fiton personalitet juridik me regjistrimin në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.

##### Neni 3

###### Objekti i shoqërisë

Shoqëria ka për objekt kryerjen e aktiviteteve tregtare në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi.

Në mënyrë më specifike, aktiviteti bazë i kësaj Shoqërie do të jetë : Konsulencë juridike, shërbime avokatie, perfaqësim ligjor në gjykatat dhe institucionet e shteti shqiptar.

Transport turistik nderkombetar te udhetareve. Agjensi

udhetimi turistike. Agjensi

transporti udhetaresh nderurban, urban, nderqytetas brenda vendit, mjete me qera (rent a car).

Konsulencë manaxheriale per shërbime

restorante, agjensi udhetimi, hoteleri. Organizim te

trainimeve dhe programeve edukuese ne industrine e

turizmit. Shërbime transporti per korporata, kompani dhe

institucione te ndryshme. Shërbime catering per korporata

dhe institucione. Shërbime te sigurise ne udhetim per

korporata dhe institucione. Shërbime shitje, blerje, pasurive

te paluajtshme, Real Estate. business travel dhe mobility Organizim i

eventeve dhe aktiviteteve në çdo fushë tregtare, kulturore, artistike, si

dhe evente që lidhen me mbrojtjen e të drejtave të njeriut, mjedisit,

ndryshimet klimaterike, promovimin e kulturës, sportit dhe traditës

shqiptare etj. Organizmi dhe hartimi i materialeve për realizimin e konferencave, simpozium, seminareve, tryezave të rrumbullakëta etj. Krijimi, aplikimi dhe zbatimi i projekteve të ndryshme kulturore, artistike, tregtare, sportive etj. Në arenën kombëtare dhe ndërkombëtare Së fundi, Shoqëria mund të kryejë çdo operacion dhe veprimtari tregtare, me individë, shoqëri tregtare, ente publike apo private, në lidhje me aktivitetin e saj bazë, siç citohet në pikën 1 të nenit 2 të Statutit. Në përgjithësi, Shoqëria mund të kryejë çdo aktivitet tjetër të nevojshëm apo të dobishëm për realizimin e qëllimeve të shoqërisë.

Neni 4

Selia

Selia e Shoqërisë është në adresën: Tiranë Tiranë TIRANË Rruga Bul Bajram Curri" AGIMI", SH 111 C1, AP 210, .pasuria nr.2/107+11-215/2, zona kadastrale 7270 Transferimi i selisë së Shoqërisë në një vend tjetër bëhet me vendimin e Asamblesë së Përgjithshme. Asambleja e Përgjithshme mund të vendosë hapjen e filialeve, degëve dhe përfaqësive të Shoqërisë në qytete të tjera të Shqipërisë ose në shtete të tjera.

Neni 5

Kohëzgjatja e veprimtarisë

Kohëzgjatja e veprimtarisë së Shoqërisë do të jetë për një afat të papërcaktuar.

## KAPITULLI II

KAPITALI THEMELTAR, ORTAKET, KONTRIBUTET, NDARJA  
DHE TRANSFERIMI I KUOTAVE

Neni 6

Kapitali themeltar dhe ortaku i vetëm

Kapitali themeltar i shoqërisë është 10.000 Lek

Kapitali themeltar i shoqërisë përbëhet nga 2 kuota, e nënshkruar dhe e shlyer, me vlerë nominale 10.000 Lek.

Ortakët e shoqërisë janë:

Z Donald Saliaj, datëlindjes 09.06.1993, lindur në Tiranë, dhe banues në Tiranë, mbajtës i Letërnjoftimit me nr. J30609061K

Z.Ertis Bregu, i datëlindjes 14.03.1993, lindur në Kucovë dhe banues në Tiranë, mbajtës i letërnjoftimit me nr, J30314063T

Përgjegjësia e secilit ortakut shtrihet deri në shumën e kontributit në kapitalin themeltar.

Neni 7

Kontributet



Kontributi në kapitalin e shoqërisë është ofruar si më poshtë:  
Z Donald Saliaj, ka ofruar një kontribut në para të barabartë me 5000  
Z Ertis Bregu, ka ofruar një kontribut në para të barabartë me 5000

Sipas kontributeve të mësipërme:

Z Donald Saliaj, ka të drejtën e 1 kuote, që i korrespondon 50 % (Pezjete përqind) të kapitalit të Shoqërisë.

Z ERTIS BREGU, ka të drejtën e 1 kuote, që i korrespondon 50 % (pezjete perqind) të kapitalit të Shoqërisë.

Neni 8

Rritja e kapitalit themeltar

Kapitali themeltar mund të rritet pa kufi në çdo moment, një ose disa herë, me vendim të Asamblesë së Përgjithshme, sipas rasteve të parashikuara në ligjin nr.9901 me datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar.

Në rast rritjeje të kapitalit, ortakët marrin vendim për rritjen e kapitalit

Neni 9

Zvogëlimi i kapitalit themeltar

Shoqëria mund të zvogëlojë kapitalin themeltar me vendimin e Asamblesë së Përgjithshme. Në çdo rast kapitali themeltar nuk mund të zvogëlohet nën kufijtë e parashikuar nga ligji.

Zvogëlimi i kapitalit përballohet nga ortakët e Shoqërisë.

Neni 10

Transferimi i kuotave

Kuotat janë lirisht të transferueshme.

Kuotat transformohen në çdo lloj forme si:

me shitje

dhurim\trashëgimi

çdo mënyrë tjetër të parashikuar në ligj

Në një rast të tillë ortaku që do të transferojë kuotën e tij, duhet të njoftoj ortakët e tjerë, me letër rekomande me kthim përgjigje, mbi synimin për shitje, duke përcaktuar çmimin, kushtet, modalitetet, emrin e blerësit dhe afatet e transferimit. E drejta e parablerjes duhet t'i referohet të gjitha kuotave të ofruara për shitje.

Ortakët do të kenë në dispozicion 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga marrja e letrës rekomande, për t'i komunikuar ortakut që transferon kuotat, synimin e tyre për të ushtruar apo jo të drejtën e parablerjes. Në rast se ata nuk përgjigjen në afatin e caktuar, prezumohet se kanë hequr dorë nga e drejta e tyre e parablerjes.

Në rast se oferta pranohet nga disa ortakë, kuotat e ofruara nga ortaku që transferon kuotat, do të ndahen nga ortakët pranues, në të njëjtën masë me kuotat që ata zotërojnë, përveç rastit kur ka një marrëveshje të kundërt.

Në asnjë rast, pranuesi i ofertës nuk mund të ushtrojë pjesërisht të drejtën e parablerjes.

Në rast se nuk ushtrohet e drejta e parablerjes, kuotat mund t'u transferohen të tretëve plotësisht apo pjesërisht, me vendimin pozitiv të Asamblesë së Përgjithshme.

Në rast të transferimit të kuotave për shkak trashëgimie mortis causa ortakët e tjerë kanë të drejtë të shprehin pëlqimin e tyre për ortakët e rinj. Në rast se nuk jepet pëlqimi, kuotat mund t'u transferohen të tretëve plotësisht apo pjesërisht.

### KAPITULLI III

#### ASAMBLEJA, ADMINISTRATORËT dhe ekspertI kontabël

##### Neni 11

Asambleja e Përgjithshme dhe kompetencat e saj

Organi vendim-marrës i Shoqërisë është Asambleja e Përgjithshme. Asambleja e Përgjithshme është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për çështjet vijuese: ndryshimet e statutit, emërimi e shkarkimi i administratorëve, ekspertëve kontabël e likuidatorëve, zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit, transferimi i kuotave, shpërndarja e fitimeve, riorganizimi dhe prishja e shoqërisë, miratimi i bilancit dhe për çdo vendim tjetër të parashikuar nga ky Statut apo nga legjislacioni përkatës.

##### Neni 12

E drejta e pjesëmarrjes dhe e votës

çdo ortak ka të drejtë të marrë pjesë në Asamble, të paraqesë mendimin e tij dhe të japë aq vota sa është numri i kuotave që ai zotëron. çdo ortak ka të drejtë të përfaqësohet nga një person tjetër jo-ortak, i pajisur me prokurë me shkrim, me anën e së cilës mund të japë votën e tij. Ortaku nuk mund të lëshojë prokurë për votim për një pjesë të kapitalit që zotëron, në qoftë se voton personalisht për pjesën e mbetur.

##### Neni 13

Thirrja e Asamblesë së Përgjithshme, kuorumi dhe vendimet

Asambleja e Përgjithshme thirret të paktën një herë në vit, brenda 6 (gjashtë) muajve nga mbyllja e vitit financiar për miratimin e bilancit, të raportit të Administratorit, ekspertit kontabël si dhe inventarit. Asambleja mund të thirret në çdo moment nga një prej Administratorëve si dhe prej një ose disa ortakëve që përfaqësojnë të paktën 5% (pesë përqind) të kapitalit themeltar. Asambleja duhet të thirret nëpërmjet njoftimit të ortakëve të paktën 7 ditë përpara datës së parashikuar për mbledhjen e Asamblesë. Thirrja duhet të përmbajë informacion mbi rendin e ditës në lidhje me çështjet që do të trajtohen dhe për të cilat do të merret vendim, mbi vendin, orën dhe datën e mbledhjes.

Asambleja mund të thirret edhe jashtë selisë së Shoqërisë.

Asambleja do të thirret dhe mbahet rregullisht edhe pa respektimin e formaliteteve të njoftimit, në rast se janë të pranishëm ortakët që përfaqësojnë të tërë kapitalin themeltar, të cilët janë dakord të marrin vendime pavarësisht parregullsisë së njoftimit.



Vendimet e Asamblesë së Përgjithshme, për të cilat është e nevojshme një shumicë e zakonshme, janë të vlefshme nëse janë të pranishëm ortakët me të drejtë vote që zotërojnë më shumë se 30% (tridhjetë përqind) të kapitalit themeltar. Vendimet e Asamblesë së Përgjithshme, për të cilat është e nevojshme një shumicë e cilësuar, janë të vlefshme nëse janë të pranishëm ortakët me të drejtë vote që zotërojnë të paktën 51% (pesëdhjetë e një përqind) të kapitalit themeltar.

Asambleja e Përgjithshme vendos për ndryshimet e satutit, zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, transferimin e kuotave, shpërndarjen e fitimeve dhe dividendëve, përcakton politikat tregëtare dhe ekonomike të shoqërisë dhe mbikqyr zbatimin e këtyre të fundit nga Administratori, emëron dhe shkarkon administratorin, emëron dhe shkarkon ekspertin (ët) kontabël dhe/ose likujduesin (ët) e Shoqërisë, përcakton shpërblimin e administratorit, ekspertëve kontabël dhe likujduesve, mbikqyr dhe miraton pasqyrat financiare vjetore dhe raportet e ecurisë së veprimtarisë të përgatitura nga administratori, autorizon një ose disa persona të jashtëm të përfaqësojnë shoqërinë në proceset gjyqësore, miraton rregullat procedurale të mbledhjeve të Asamblesë së Përgjithshme, merr vendim për çdo çështje tjetër të parashikuar nga ky statut dhe legjislati në fuqi, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë me votën pro të të paktën  $\frac{3}{4}$  (tre të katërtat) të ortakëve pjesëmarrës, të cilët përfaqësojnë të paktën 51% (pesëdhjetë e një përqind) të kapitalit themeltar të shoqërisë. Në të gjitha rastet e tjera, Asambleja e Përgjithshme merr vendimet në mbledhje të zakonshme me votën pro të shumicës së ortakëve të pranishëm që përfaqësojnë mbi 30% (tridhjetë përqind) të kapitalit themeltar.

Asambleja drejtohet nga një ortak ose ndonjë person tjetër i caktuar nga vetë Asambleja. Për pasqyrimin e vendimit Asambleja emëron një Sekretar, që mund të jetë edhe jo-ortak.

Vendimet e Asamblesë duhet të nënshkruhen nga Kryetari i Asamblesë dhe nga Sekretari dhe regjistrohen në Regjistrin e Vendimeve. Bazuar në parashikimet ligjore një kopje e vendimit dërgohet për regjistrim pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit.

Neni 14

Administrimi

Shoqëria administrohet nga një ose më shumë Administratorë, të cilët do të veprojnë si veçmas ashtu edhe bashkërisht. Administratorët do të qëndrojnë në detyrë deri në shkarkim apo dorëheqje.

Përfaqësimi ligjor i Shoqërisë u besohet Administratorëve. Administratorët mund të ushtrojnë të gjitha kompetencat për administrimin e zakonshëm dhe të jashtëzakonshëm të Shoqërisë, konform me sa parashikohet në nenin 95 të Ligjit nr.9901 të datës 14.04.2008 "Për tregtarët dhe Shoqëritë tregëtare", i ndryshuar.

Administratorët mund të emërojnë përfaqësues të posaçëm për veprime apo kategori të caktuara veprimesh.

Administratori i Shoqërisë është:

Z DONALD SALIAJ, i datëlindjes 09.06.1993, lindur në Tiranë, dhe banues në Tirane, mbajtës i Letërnjoftimit me nr.J30609061K, ortak i shoqërisë, i cili do të qëndrojë në detyrë për një periudhë 5 vjecare, me të drejtë ripërtëritjeje.



Shoqëria përfaqësohet ndaj të tretëve me nënshkrimin e administratorit. Administratori i Shoqërisë administron veprimtarinë e shoqërisë duke zbatuar politikën tregtare dhe ekonomike të përcaktuara nga Asambleja e Përgjithshme, përfaqëson Shoqërinë në marrëdhënie me çdo palë të tretë, merr masa për hartimin dhe mbajtjen në mënyrën e duhur të pasqyrave financiare dhe të dokumentave, përgatit dhe nënshkruan pasqyrat vjetore financiare dhe bilancet e konsoliduara, përgatit raportin e ecures dhe i dorëzon këto të fundit bashkë me propozimin përkatës për shpërndarjen e fitimeve në Asamblenë e Përgjithshme për miratim, krijon sistemin e paralajmërimit në lidhje me rrethanat të cilat kërcënojnë veprimtarinë e Shoqërisë, dorëzon në QKB dokumentat dhe të dhënat e Shoqërisë përveç rasteve kur ligji parashikon ndryshe, raporton në Asamblenë e Përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare të Shoqërisë dhe në lidhje me përmbushjen e transaksioneve të një rëndësie të veçantë për ecurinë e Shoqërisë, kryen çdo detyrë tjetër të parashikuar nga ligji ose nga ky statut, është i autorizuar për të siguruar mjetet financiare dhe kredi, të lidhë marrëveshje përkatëse me banka, institucione krediti ose financiare vëndase ose të huaja, duke përdorur si mjete garancie në bazë të legjisllacionit shqiptar në fuqi asetet e Shoqërisë.

Neni 15

Eksperti kontabël i autorizuar

Me vendim të Asamblesë së Përgjithshme, kontrolli i bilanceve dhe librave kontabël të Shoqërisë mund t' i besohet një ose disa ekspertëve kontabël të autorizuar.

Eksperti kontabël i autorizuar mund të shkarkohet sipas mënyrës së parashikuar nga legjisllacioni në fuqi.

#### KAPITULLI IV

#### VITI FINANCIAR, BILANCI VJETOR, SHPËRNDARJA E FITIMEVE

Neni 16

Viti financiar dhe bilanci vjetor

Viti financiar fillon më 1 janar dhe mbaron më 31 dhjetor të secilit vit. Viti i parë financiar fillon në datën e regjistrimit të Shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe përfundon më 31 dhjetor të të njëjtit vit. Bilancet vjetore, inventari, raportet e Administratorit dhe të ekspertit kontabël të autorizuar miratohen nga Asambleja me shumicën e kërkuar nga ligji nr.9901 me datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar.

Miratimi i dokumentave që lidhen me vitin financiar duhet të bëhet brenda 6 (gjashtë) muajve nga fundi i vitit financiar ose brenda afateve të parashikuar nga legjisllacioni tatar.

Neni 17

Fitimet

Fitimet që rezultojnë nga bilanci vjetor, u shpërndahen ortakëve në proporcion me pjesët e kapitalit themeltar të zotëruar.

Fitimet ndahen në formën e dividendëve pas lëshimit të Certifikatës paguese në përputhje me ligji nr.9901 me datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar dhe legjilacionin tatimor në fuqi. Asambleja mund të vendosë edhe zbritje të veçanta në favor të rezervave të jashtëzakonshme ose për qëllime të tjera apo dhe shtyrjen e shpërndarjes së fitimeve plotësisht ose pjesërisht për vitet financiare të ardhshme.

#### KAPITULLI V SHPËRNDARJA DHE LIKUIDIMI I SHOQËRISË

Neni 18  
Prishja e Shoqërisë

Shoqëria priset me përfundimin e afatit të parashikuar nga Statuti, ose përpara përfundimit në rastet e parashikuara nga ligji, ose me anë të një vendimi të Asamblesë së Përgjithshme, me shumicën e kërkuar për ndryshimet në statut.

Shoqëria nuk priset në rast të humbjes së zotësisë për të vepruar, vdekjes, ose falimentimit të ortakëve.

Neni 19  
Likuidimi

Në rast prishje, Shoqëria duhet të likuidohet.

Për të administruar këtë procedurë, Asambleja e Përgjithshme emëron një ose më shumë likuidatorë, të cilët paraqesin raportet përfundimtare mbi gjendjen e aktivitetit dhe pasivitetit të Shoqërisë, mbi operacionet e likuidimit dhe mbi kohën e nevojshme për të përfunduar likuidimin.

Me përfundimin e procedurës së likuidimit, Asambleja e Përgjithshme do të vendosë mbi bilancin financiar përfundimtar, mbi punën e kryer nga likuiduesi dhe mbi përfundimin e procesit të likuidimit.

Pas pagimit të kreditorëve dhe mbledhjes së kredive, likuidatori do t'i shpërndajë të ardhurat përfundimtare të likuidimit ortakëve, në proporcion me pjesët e kapitalit të zotëruara prej tyre në kapitalin themeltar.

Neni 20  
Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Të gjitha mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me interpretimin dhe/ose zbatimin e këtij statuti dhe aktit të themelimit, si edhe ato që mund të lindin në përgjithësi midis ortakëve (përveç atyre personale apo jashtë Shoqërisë) ose midis një apo më shumë ortakëve dhe Shoqërisë, do të zgjidhen në mënyrë miqësore dhe do të diskutohen në mënyrë të drejtpërdrejtë ndërmjet palëve të interesuara.

Në rast se nuk arrihet një zgjidhje miqësore të mosmarrëveshjes, ato do t'i besohen Gjykatës së Shkallës së Parë, Juridiksioni Përgjithshëm Tiranë.

Ortakët

DONALD SALIAJ



Ortakët

ERTIS BREGU

